



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.656/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Zyhdi Haziri anëtar, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares Lgjore Anita Peci, duke vendosur përkitazi me apelin e Rustem Thaçit dhe Albert Dervishit kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Gllogoc, nga subjekti politik Nisma për Kosovën, me seli në Prishtinë, dega në Gllogoc, paraqitur kundër vendimit Nr.2232-2017 të datës 08.11.2017, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Kuvendet Komunale, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet pjesërisht si i bazuar apeli i Rustem Thaçit dhe Albert Dervishit kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Gllogoc, nga subjekti politik Nisma për Kosovën, paraqitur kundër vendimit Nr.2232-2017 të datës 08.11.2017, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Kuvendet Komunale, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj fletëvotimet për Rustem Thaçin si dhe Albert Dervishin, të dy kandidatë për anëtar të Kuvendit Komunal në Gllogoc, nga radhët e subjektit politik Nisma, dega në Gllogoc, në Vendvotimin: 0302E/01R.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutit e Vendvotimeve si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

IV. Refuzohet si i pabazuar apeli në raport me vendvotimin: 0319E.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 09.11.2017, nga Rustem Thaçit dhe Albert Dervishit kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Gllogoc, nga subjekti politik Nisma me të cilin pretendojnë se në vendvotimin 0302E/01R ka pasur manipulim me vota si dhe parregullsi, ku në formularët e rezultateve janë paraqitur në mënyrë jo reale votat e tyre. Po ashtu edhe për vendvotimin 01319E kërkojnë rinumërim të votave për shkak të parregullsive gjatë numërimit.

Parashtruesit e apelit si dëshmi kanë bashkangjitur formularin e rezultateve.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

apeli është i bazuar

Paneli gjeti se pretendimet në apel janë të bazuara, për faktin që pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, ka vlerësuar se ka parregullsi në lidhje me numrin e votave të parashtruesve të apelit, siç rezulton edhe nga shkresat e lëndës andaj, mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për të dy kandidatët nga radhët e subjektit politik Nisma, në vendvotimin e cekur në pjesën e dytë të dispozitivit dhe rezultati i dalur nga rinumërimi të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të datës 22.10. 2017. Ndërsa sa i përket pretendimit për vendvotimin 01319E, Paneli vlerësoi se nuk mund të identifikohet sakt se për cilin vendvotim bëhet fjalë në apel andaj edhe e refuzoi pjesërisht apelin.

Prandaj, me qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura, Paneli vendosi si në pjesën e dytë të dispozitivit dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu nga sa u tha më sipër, bazuar me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr. 656/2017 më datën 12.11.2017.



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.